



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, _____.2021

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT¹)

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik DELTA PHARMA – AL Sh.p.k me NIPT K62202046U** me adrese, *Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, km.3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/.*

* * *

Procedura e prokurimit: Blerje barna spitalore per nje periudhe 12 mujore, e ndare ne lote.

Numri i referencës së procedurës : REF-04251-08-31-2021

Loti 6: REF-04264-08-31-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje barna spitalore per nje periudhe 12 mujore, e ndare ne lote.

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave të Marrëveshjes Kuadër (në total për 9 lote):

56 906 743,318 (pesedhete e gjashte milion e nenteqind e gjashte mije e shtateqind e dyzet e tre pike treqind e tetembedhete) **lekë pa TVSH.**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës per Lotin 6: Omeprazol/40 mg /Flakon + ampule/flakon (hollues): 20 098 308,38 (njezet milion e nentedhete e tete mije e treqind e tete pike tridhete e tete) lek pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Me Afat 1 vjeçar (12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

¹ Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

- **Operatori Ekonomik MEGAPHARMA Sh.p.k me NIPT J61814028F**, me vlerë të pritshme të kontratave **8,387,971.2** (tetë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë dy) **lekë pa TVSH.**
- **Operatori Ekonomik ALBANIA NEW FARM Sh.p.k me NIPT K53717806Q**, me vlerë të pritshme të kontratave **9,094,848** (nëntë milion e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e tetë) **lekë pa TVSH.**
- **Operatori Ekonomik DELTA PHARMA – AL Sh.p.k me NIPT K62202046U**, me vlerë të pritshme të kontratave **11,030,880** (njëmbëdhjetë milion e tridhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH.**
- **Operatori Ekonomik EVITA Sh.p.k me NIPT L31714005J**, me vlerë të pritshme të kontratave e **15,128,064.00** (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- **Operatori Ekonomik EDNA FARMA Sh.p.k me NIPT K01515004T**, me vlerë të pritshme të kontratave **19,810,560** (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e dhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

- **Operatori Ekonomik MEGAPHARMA Sh.p.k me NIPT J61814028F**, me vlerë të pritshme të kontratave **8,387,971.2** (tetë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë dy) **lekë pa TVSH**, per arsytet si me poshte:

Në DST, pika 22. **Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta, parashikohet që:**

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.**

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët, në këto kushte, KVO përlogariti ofertat e administruara për Lotin 6: Omeprazol/40 mg /Flakon + ampule/flakon (hollues): 20 098 308,38 (njëzet milion e nentëdhjetë e tete mijë e treqind e tete pike tridhjetë e tete) lek pa TVSH, si më poshtë:

Nr.	OE Ofertues	a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
1	Megapharma	8 387 971,20Lek
2	Albania New Farm	9 094 848,00Lek
3	Deltapharma	11 030 880,00Lek
4	Evita	15 128 064,00Lek
5	Edna Farma	19 810 560,00Lek

KVO përlogariti sipas formulës kur ka dy ose më shumë oferta ekonomike të vlefshme:

Nr.	Ofertat	OE Ofertues	a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
1	O	Megapharma	8 387 971,20Lek
2		Albania New Farm	9 094 848,00Lek
3		Deltapharma	11 030 880,00Lek
4		Evita	15 128 064,00Lek
5		Edna Farma	19 810 560,00Lek
MO			12 690 464,64
ZM = 85% Mo			10 786 894,94
Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM.....			
Megapharma			8 387 971,20Lek
			<u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>
Albania New Farm			9 094 848,00Lek
			<u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>

Për këtë arsye, KVO ju drejtua dy operatorëve me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët, si më poshtë:

OE MEGAPHARMA SH.P.K:

Lënda: Kërkesë për argumentim të ofertës anomalisht të ulët!

OPERATORIT EKONOMIK “MEGAPHARMA” Sh.p.k me NIPT J61814028F

Adresë: Rruga e Elbasanit, Mjull – Bathore, Nr.4, përballë TEG.

*Bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 93, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje barna spitalore për një periudhë 12 mujore, e ndarë në lote”, me FL (në total për 9 lote): 56 906 743,318 (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzet e tre pikë treqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, me REF-04251-08-31-2021, konkretisht për Lotin 6: Omeprazol/40 mg /Flakon + ampulë/flakon (hollues) me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 20 098 308,38 (njëzet milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH **rezulton se Oferta juaj është Anomalisht e ulët.***

Referuar përcaktimit të bërë në nenin 93, pika 1, ku citohet se: Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, si dhe...;

Si dhe neni 82 i VKM nr. 285/2021, pika 4 ku citohet se: 4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit...;

...Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

Sa më sipër, keni detyrimin të argumentoni dhe dokumentoni me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës tuaj në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP dhe 82/4 të RrPP, brenda datës 15.10.2021 ora 14:00.

Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën, konform ligjit në fuqi.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Në përgjigje të kërkesës së KVO, me datë: 15.10.2021, ora 09:51, OE argumenton si më poshtë:

Lenda: Informacion per oferte.

Persa kerkohet ne mesazhin elektronik ne faqen e APP/ SPE date 12.10.2021, mbi oferten e shoqerise Megapharma shpk ne proceduren e prokurimit me objekt "Blerje barna spitalore per nje periudhe 12 mujore, e ndare ne lote", me FL (ne total per 9 lote): 56 906 743,318 (pesedhjete e gjashte milion e nenteqind e gjashte mije e shtateqind e dyzet e tre pike treqind e tetembedhjete) leke pa TVSH, me REF-04251-08-31-2021, konkretisht per Lotin 6: Omeprazol/40 mg /Flakon + ampule/flakon (hollues) me fond limit/vlera e pritshme e kontrates: 20 098 308,38 (njezet milion e nentedhjete e tete mije e treqind e tete pike tridhjete e tete) leke pa TVSH, per oferten e Megapharm shpk sqarojme se:

Çmimi per njesi i ofertes per Lot 6 : Omeprazol/40 mg /Flakon + ampule/flakon (hollues) eshte i ulet ne raport çmimin per njesi te fondit limit per shkak se MAH/kompania prodhuese "Anfarm Hellas" i ka ofruar Megapharm shpk tjeter çmim per pjesemarjen ne tenderin publike nga çmimi i shitjes me pakice, si dhe duke mare parasysh sasite qe levrohen, kohezgjatjen e Marreveshjes Kuader, duke konsideruar dhe ofertat e opertoreve te tjere konkurues te mundshem (per kete bar ne procedure e fundit ishin tre ofertues).

Bashkelidhur gjeni dhe e-mail te derguar nga kompania "Anfarm Hellas", sipas kerkeses se bere nga ana jone pas marrjes se kerkeses per informacion nga QSU "Nene Tereza" (KVO) me mesazhin e sipercituar, ne te cilin konfirmohet çmimi dhe garantohet furnizimi i barit sipas ketij çmimi te ofruar ne tender.

Gjejme rastin te theksojme angazhimin tone per realizimit e plote dhe me korrektesi te kontrates eventuale per barnat e ofruara nga ana jone.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin, Me respekt,

Rasim Hamzaraj Administrator

Ne mungese me porosi

Irgen Shahu

Emaili bashkëlidhur:

George Kazantzoglou - Anfarm [gkazantzoglou@anfarm.com]

Friday, October 15, 2021 9 23 AM Irgen Shahu

r.hamzaraj@megapharm.al; 'Egon Babameto'; Aliko Kakolyri - Anfarm; Nikos Tsilimis - Anfarm RE: Eselan 40mg tender price Albania

Dear Irgen,

We can confirm that Anfarm Hellas will deliver Eselan (omeprazole) - Powder and solvent for solution for injection 40 mg/ vial to the Albanian market with the supply price agreed to Megapharm for the tender.

kindest regards, George

Dokumentacionin e administruar në SPE, e ka paraqitur edhe në rrugë shkresore me nr. 2229/17 prot., datë 15.10.2021;

Për sa më sipër, KVO konstaton se në legjislacionin e prokurimit publik parashikohet që:

VKM 285/2021, Neni 82 'Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave', pika 4: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

LPP/Neni 93 'Oferta anomalisht e ulët' parashikohet se:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune **shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.**

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, KVO vlerëson se nga interpretimi literal i nenit 82/pika 4 e RrPP, ku citohet ndër të tjera që: **...Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e**

nenit 93, të LPP-së, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si anomalisht e ulët nga KVO, në zbatim të VKM 285/2021. Gjithashtu argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë pesë kushte kumulative të parashikuara në nenin 93/2 të LPP, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar **anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit**, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi, pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, si dhe mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Të pestë kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët.

Referuar nenit 93 pika 2 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **Në rastin në fjalë, OE nuk ka paraqitur anën ekonomike të ndërtimit të ofertës;**

KVO gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët.

Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: *rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët etj.* Nga praktika e AK, rezulton se nga eksperiencia në procedura të ngjashme (shembull - REF-82091-12-14-2020) risku i furnizimit ndaj një OE që ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët është shumë i lartë;

Gjithashtu, KVO thekson se referuar nenit 1/ pika 2 dhe nenit 2 të LPP, ku parashikohet se: Neni 1 ‘**Objekti**’ pika 2: *Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.* Neni 2 ‘**Qëllimi**’ Qëllim i këtij ligji është: a) **të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;** b) **të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të**

ulë shpenzimet procedurale.; Mire përdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “*oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim* ”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

KVO në këto kushte, sqaron se ligjvënësia ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulëta të cilat në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e kostos të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 93 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë **duhet të dëshmojnë se përmbushin 5 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në VKM.**

Në rastin konkret KVO gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Megapharma” Shpk nuk është i plotë dhe nuk krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës së shpallur nga AK. Konkretisht operatori ekonomik Megapharma shpk., përveç paraqitjes së deklaramit narrativ lidhur me përmbushjen e kushteve për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët ku nuk paraqet një analizë çmimi, apo metodën e ndërtimit të ofertës, ka paraqitur dhe një email të së njëjtës formë, të prodhuesit, ku citohet se do të realizojë plotësisht kontratën sipas çmimit të ofertuar, duke mos dhënë asnjë informacion mbi çmimin e blerjes nga prodhuesi, kosto transporti, marzh fitimi, kosto administrative etj., duke mos krijuar kështu bindjen se operatori ekonomik ka aftësi për të realizuar me sukses furnizimin me mallra objekt prokurimi me çmimin e ofertuar, pasi në asnjë moment nuk provohet dhe me pas dokumentohet me prova shkresore, se plotësohen kushtet kumulative të përcaktuara nga legjislatori, si dhe se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Për këtë arsye, KVO vlerëson se oferta e paraqitur nga OE Megapharma sh.p.k., është e pavlefshme.

- **Operatori Ekonomik ALBANIA NEW FARM Sh.p.k me NIPT K53717806Q**, me vlerë të pritshme të kontratave **9,094,848** (nëntë milion e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e tetë) **lekë pa TVSH**, per arsyet si me poshte:

Në DST, pika 22. **Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta, parashikohet që:**

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.**

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët, në këto kushte, KVO përlogariti ofertat e administruara për Lotin 6: Omeprazol/40 mg /Flakon + ampule/flakon (hollues): 20 098 308,38 (njëzet milion e nentdhjete e tete mije e treqind e tete pike tridhjete e tete) lek pa TVSH, si më poshtë:

Nr.	OE Ofertues	a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
1	Megapharma	8 387 971,20Lek
2	Albania New Farm	9 094 848,00Lek
3	Deltapharma	11 030 880,00Lek
4	Evita	15 128 064,00Lek
5	Edna Farma	19 810 560,00Lek

KVO përlogariti sipas formulës kur ka dy ose më shumë oferta ekonomike të vlefshme:

Nr.	Ofertat	OE Ofertues	a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;	
1	O	Megapharma	8 387 971,20Lek	
2		Albania New Farm	9 094 848,00Lek	
3		Deltapharma	11 030 880,00Lek	
4		Evita	15 128 064,00Lek	
5		Edna Farma	19 810 560,00Lek	
MO			12 690 464,64	
ZM = 85% Mo			10 786 894,94	
Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM.....				
Megapharma			8 387 971,20Lek	<u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>
Albania New Farm			9 094 848,00Lek	<u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>

Për këtë arsye, KVO ju drejtua dy operatorëve me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët, si më poshtë:

OE “ALBANIA NEW FARM” Sh.p.k:

Lënda: Kërkesë për argumentim të ofertës anomalisht të ulët!

***OPERATORIT EKONOMIK “ALBANIA NEW FARM” Sh.p.k me NIPT
K53717806Q***

Adresë: Rr. ”Dhimertika”, Lagjia nr. 1, Banesa nr. 7, Sarandë, Vlorë.

Bazuar në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 93, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje barna spitalore për një periudhë 12 mujore, e ndarë në lote”, me FL (në total për 9 lote): 56 906 743,318 (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzet e tre pikë treqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, me REF-04251-08-31-2021, konkretisht për Lotin 6: Omeprazol/40 mg /Flakon + ampulë/flakon (hollues) me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 20 098 308,38 (njëzet milion e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH rezulton se Oferta juaj është Anomalisht e ulët.

Referuar përcaktimit të bërë në nenin 93, pika 1, ku citohet se: Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, si dhe...;

Si dhe neni 82 i VKM nr. 285/2021, pika 4 ku citohet se: 4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit..;

...Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

Sa më sipër, keni detyrimin të argumentoni dhe dokumentoni me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës tuaj në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP dhe 82/4 të RrPP, brenda datës 15.10.2021 ora 14:00.

Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën, konform ligjit në fuqi.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Në përgjigje të kërkesës së KVO, me datë: 13.10.2021, ora 20:37, OE argumenton si më poshtë:

Lenda: Informacion për çmimin e ofertës.

Shoqëria ALBANIA NEW FARM ka paraqitur ofertë Lotin 6 Omeprazol/40 mg /Flakon + ampulë/flakon (hollues) në procedurën e prokurimit me: “Blerje barna spitalore për një periudhë 12 mujore, e ndarë në lote”.

Nga ana juaj çmimi i ofruar nga ana jonë u konsiderua si anomalisht i ulët.

Për këtë arsye ju dërgojmë sqarimet si më poshtë:

Shoqëria ALBANIA NEW FARM cmimin e paraqitur në këtë ofertë e ka vendosur në marrëveshje me kompaninë prodhuese VIANEX S.A e cila na garanton sigurimin e furnizimit të medikamentit me këtë cmim dhe po është e nevojshme ju dërgojmë dhe vërtetim nga kompania prodhuese VIANEX S.A.

Shoqëria ALBANIA NEW FARM dhe kompania prodhuese VIANEX S.A për medikamentet e ofruara nga kompania VIANEX ka marrë pjesë dhe në tenderat e viteve të kaluara edhe i kemi realizuar me sukses.

Prandaj edhe këtë ofertë do ta realizojmë me sukses dhe në kohën e duhur me mbështetjen e kompanisë VIANEX.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se në këto momente ne e kemi mallin në magazinë dhe e kemi gati për ta dorëzuar të gjithë sasinë e kërkuar në tender. Prandaj autodeklarojmë furnizimin e institucionit me këtë medikament sipas kërkesave të procedurës së prokurimit.

Dokumentacionin e administruar në SPE, nuk e ka paraqitur në rrugë shkresore;

Për sa më sipër, KVO konstaton se në legjislacionin e prokurimit publik parashikohet që:

VKM 285/2021, Neni 82 ‘Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave’, pika 4: *Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.*

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

LPP/Neni 93 ‘Oferta anomalisht e ulët’ parashikohet se:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, KVO vlerëson se nga interpretimi literal i nenit 82/pika 4 e RrPP, ku citohet ndër të tjera që: ...Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e vecanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si anomalisht e ulët nga KVO, në zbatim të VKM 285/2021. Gjithashtu argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë pesë kushte kumulative të parashikuara në nenin 93/2 të LPP, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar **anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së**

ndërtimit, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi, pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, si dhe mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Të pestë kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët.

Referuar nenit 93 pika 2 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **Në rastin në fjalë, OE nuk ka paraqitur anën ekonomike të ndërtimit të ofertës;**

KVO gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët.

Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: *rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët etj., Nga praktika e AK, rezulton se nga eksperiencia në procedura të ngjashme (shembull - REF-82091-12-14-2020) risku i furnizimit ndaj një OE që ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët është shumë i lartë;*

Gjithashtu, KVO thekson se referuar nenit 1/ pika 2 dhe nenit 2 të LPP, ku parashikohet se: Neni 1 ‘**Objekti**’ pika 2: *Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.* Neni 2 ‘**Qëllimi**’ Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale.; Mire përdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “*oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim*”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

KVO në këto kushte, sqaron se ligjvënsësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta të cilat në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e kostos të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 93 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë **duhet të dëshmojnë se përmbushin 5 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në VKM.**

Në rastin konkret KVO gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “ALBANIA NEW FARM” Sh.p.k nuk është i plotë dhe nuk krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës së shpallur nga AK. Konkretisht operatori ekonomik “ALBANIA NEW FARM” Sh.p.k., përveç paraqitjes së deklaratimit narrativ lidhur me përmbushjen e kushteve për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët ku nuk paraqet një analizë çmimi, apo metodën e ndërtimit të ofertës, ka paraqitur dhe një email të së njëjtës formë, të prodhuesit, ku citohet se do të realizojë plotësisht kontratën sipas çmimit të ofertuar, duke mos dhënë asnjë informacion mbi çmimin e blerjes nga prodhuesi, kosto transporti, marzh fitimi, kosto administrative etj., duke mos krijuar kështu bindjen se operatori ekonomik ka aftësi për të realizuar me sukses furnizimin me mallra objekt prokurimi me çmimin e ofertuar, pasi në asnjë moment nuk provohet dhe me pas dokumentohet me prova shpresore, se plotësohen kushtet kumulative të përcaktuara nga legjislatori, si dhe se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Për këtë arsye, KVO vlerëson se oferta e paraqitur nga OE “ALBANIA NEW FARM” Sh.p.k., është e pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

- **Operatori Ekonomik DELTA PHARMA – AL Sh.p.k me NIPT K62202046U, me vlerë të pritshme të kontratave 11,030,880 (njëmbëdhjetë milion e tridhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.**

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tirane sigurimin e kontratës brenda 5 ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesat:

Në lidhje me vlerësimin e bërë është paraqitur ankesë nga OE “MEGAPHARMA” Shpk nr. 245 prot., datë 27.10.2021, administruar në Autoritetin Kontraktor Qendra Spitalore Universitare

“Nënë Tereza” me nr. 2743 prot., datë 28.10.2021 me objekt: “Kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës dhe kualifikimin e ofertës së MEGAPHARMA Sh.p.k.

Me vendimin nr. 2743/2 prot., datë 02.11.2021 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës në konkluzion ka vendosur: “***Të mos pranojë pretendimet e paraqitura nga OE MEGAPHARMA Sh.p.k., në ankesën e administruar me nr. 2743 prot., datë 28.10.2021***”.

KPP me Vendimin nr. ***nr.894/2021 prot., datë 16.11.2021, administruar në QSUNT me nr. 2743/7 prot., datë 17.11.2021 për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje barna spitalore për një periudhë 12 mujore, e ndarë në lote”, konkretisht për Lotin 6 Omeprazol/40 mg /Flakon + ampulë/flakon (hollues), ka vendosur:***

- ❖ ***Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik MEGAPHARMA Sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-04264-08-31-2021, me objekt Lot 6 Omeprazol/40 mg /Flakon + ampulë/flakon (hollues), me fond limit 20,098,308.38 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 04.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.***
- ❖ ***Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit..[.];***

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enkelejdi JOTI

**DELEGUAR ME URDHËR Nr.530/2021
Zv.DREJTORI I PËRGGJITHSHËM**

Saimir XHEPI